2020 KOSINT
Kosovo Integration Initiative
Iniciativa e Kosovës për Përfshirje

RAPORT TEMATIK

Arsyet që ndikojnë në braktisjen e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Prishtinë , shtator 2019

Raport Tematik në lidhje me arsyet që ndikojnë në braktisjen e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Ky raport është hartuar nga Petrit Tahiri me mbështetjen e projektit "Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT 2020" të financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, i zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me Balkan Sunflowers (BSFK), Syri I Vizionit (SiV) dhe Roma and Ashkalia Documentation Center (RADC).

Pikëpamjet e shprehura në këtë vlerësim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal ose pjesëmarrësve të tij, e as të Bashkimit Evropian dhe Fondacionit për Shoqëri të Hapur

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT 5
1. HYRJE 7
2. KONTEKSTI 9
3. METODOLOGJIA 11
4. TË GJETURAT E ANALIZËS 12
4.1. Faktorët individual 14
4.2. Faktorët familjarë 15
4.3. Faktorët shkollorë 16
4.4. Faktorët social 17
5. REKOMANDIMET 19
6. PËRFUNDIMET 21

SHKURTESAT

CRS -Catholic Relief Services
ECMI - Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
IPK- Instituti Pedagogjik i Kosovës
ISCED - Standardi Ndërkombëtar për Klasifikimin e Arsimit
KEC - Qendra për Arsim e Kosovës
KOSINT - Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT
MAShT - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
OJQ - Organizata jo-qeveritare
OShC - Organizata të Shoqërisë Civile
SMIA - Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SPH - Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm ()
SHPA - Shoqatat Prind-Arsimtarë
UA -Udhëzim Administrativ
UNESCO - Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
UNICEF - Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

1. HYRJE

E drejta për arsim është e garantuar me të gjitha instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë fushën e të drejtave të njeriut. Në pikën 1 të Nenit 26 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut thuhet *"Çdokush ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollën fillore dhe të mesme të ulët. Arsimi fillor është i detyrueshëm..."*. Po ashtu, në Nenin 28, të Konventës për të Drejtat e Fëmijës tregohet që *"Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim..."*. UNESCO (Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara) në vitin 1994 ka miratuar Deklaratën e Salamankës, ku në paragrafin e dytë të saj thuhet: *"Çdo fëmijë ka të drejtë themelore për arsim dhe duhet t'i jepet mundësia për të arritur dhe për të ruajtur një nivel të pranueshëm të të mësuarit"*.[1]

Në nivel të shtetit, e drejta për arsim garantohet nga të gjitha aktet ligjore, duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, [2] ku në Nenin 47, pika 1, thuhet *"Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike"*. Si vazhdimësi e kësaj, në Nenin 3 të Ligjit për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës thuhet: *"Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim"*.

E përbashkëta kryesore e të gjitha dokumenteve dhe neneve që u përmendën më lartë qëndron tek obligimi që shteti merr për të siguruar arsim për të gjithë qytetarët e vet. Pra, e drejta për arsim jo vetëm që është e garantuar, por, është edhe obligim dhe detyrim i të gjithëve. Megjithatë, mbetet sfidë e përhershme përfshirja në arsim e fëmijëve nga grupet e cenueshme dhe ato të margjinalizuara.Intervenimet dhe reformat e vazhdueshme që janë bërë në sistemin arsimor në Kosovë, në dy dekadat e fundit kanë bërë që niveli i përfshirjes së fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor, të shënojë përparim të dukshëm, veçanërisht në arsimin fillor (klasat 1-5) ku pjesëmarrja sillet te 85% [4]. Megjithatë,krahasuar me mesataren e Kosovës, pjesëmarrja nuk është ende në nivel të kënaqshëm.

1. http://www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E.PDF
2. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702
3. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770
4. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës: Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.

Për më tepër, në nivelet e larta të arsimit vërehet një trend negativ. Pra, në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) marrin pjesë vetëm 65% [5] të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian të grup-moshës 11-14, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12) pjesëmarrja e tyre zvogëlohet në 30.3%[6]. Gjithsesi, në nivel të përgjithshëm, vërehet një përparim i dukshëm i përfshirjes.

Ky trend i përmirësimit të përfshirjes së fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor, dëmtohet shumë nga fenomeni i braktisjes së shkollimit. Braktisja e shkollimit është e pranishme edhe në vende të zhvilluara dhe me sistem arsimor shumë të konsoliduar, ku gjithherë, fëmijët nga grupet e cenueshme janë më të predispozuar për t'u prekur nga ky fenomen.

Ky raport tematik ka për qëllim që të identifikojë arsyet që ndikojnë në braktisjen e shkollimit nga fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Përmes analizës së kornizës ligjore, programeve dhe projekteve intervenuese nga institucionet përgjegjëse dhe nga OShC-të, si dhe bisedave me hisedarët kryesor, është tentuar që të vihen në pah arsyet që ndikojnë në braktisjen e shkollimit. Bazuar në të gjeturat e raportit, janë hartuar edhe disa rekomandime specifike për të gjithë hisedarët e procesit.

Ky studim nuk do të mund të realizohej pa përkrahjen e drejtorëve të shkollave, mësimdhënësve, nxënësve, prindërve, bashkëpunëtorëve nga organizatat partnere. Më këtë rast, shprehim falënderim për të gjithë ata që kontribuuan me informata dhe ndihmuan realizimin e studimit.

5. Po aty
6. Po aty

2. KONTEKSTI

Që nga themelimi i Institucioneve vetë-qeverisëse në Kosovë, përkatësisht themelimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë – MAShT, gjatë hartimit të politikave arsimore i është kushtuar vëmendje e veçantë problemit të braktisjes së shkollës. Në vitin 2003 Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë, Shoqatat Prindër – Arsimtarë - SHPA dhe Catholic Relief Services – CRS,filluan zbatimin e një projekti për parandalimin e braktisjes. Ky projekt u zbatua për vite të tëra nëpër shkolla dhe kishte për qëllim krijimin e mekanizmave për parandalimin dhe trajtimin e problemit të braktisjes së shkollës.

Në vitin 2004 MAShT në bashkëpunim me UNICEF hartuan raportin "Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë". Sipas këtij studimi arsyet kryesore që ndikojnë në braktisjen e shkollimit nga nxënësit në Kosovë janë: gjendja e rëndë ekonomike; mungesa e dëshirës për shkollim nga ana e fëmijëve dhe punësimi i hershëm i fëmijëve. [7]

Gjatë vitit 2009, MAShT hartoi "Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes së shkollës" i cili nga viti 2011 u bë pjesë e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016.

Duke u bazuar në të dhënat nga SMIA – Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim dhe hulumtimet/studimet e zhvilluara, MAShT në bashkëpunim me partnerët zhvillimor kanë hartuar dhe zbatuar projekte dhe programe me qëllim të parandalimit të braktisjes. Në vitin 2012 është hartuar Udhëzimi Administrativ UA 19/2012 për Krijimin dhe fuqizimin e Ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar. Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të UA 19/2012, në bashkëpunim me ECMI dhe UNICEF, MAShT ka hartuar Doracakët për Ekipet Shkollore dhe Komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar.
Gjatë vitit 2016-2017 në kuadër të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim – SMIA, është shtuar edhe Moduli i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH) i cili gjeneron informacione për rastet që janë në rrezik të braktisjes, të cilat identifikohen dhe raportohen nga shkollat.

Gjatë vitit 2018, u rishikua dhe plotësua UA 19/2012. Ky proces u përmbyll me aprovimin e UA 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e Ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mos-regjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar.

7. "Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë", UNICEF, MAShT, Nëntor 2004

Raportet monitoruese të zbatimit të politikave dhe strategjive tregojnë që edhe përkundër intervenimeve të vazhdueshme dhe përmirësimit të kornizës ligjore, problemi i braktisjes së shkollës nga fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian mbetet i pranishëm në shkolla në nivel të lartë.

Në raportin e vlerësimit të zbatimit për vitin 2017 të Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, 4 nga 14 të gjeturat kryesore lidhen drejtpërdrejt me problemin e braktisjes së shkollimit. Në këtë raport thuhet: *"Fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, e veçanërisht vajzat, vazhdojnë të ballafaqohen me një shkallë të lartë të braktisjes së shkollimit..."*. [8]

Pra, edhe përkundër intervenimeve që janë bërë në kuadër të institucioneve përgjegjëse, apo ato të ndërmarra nga OShC-të, mbetet shumë hapësirë për tu punuar në konsolidimin e sistemit parandalues dhe reagues ndaj problemit të braktisjes.

8. RaportVlerësimipërvitin 2017- ZbatimiiStrategjisëpërpërfshirjen e komuniteteveromdhe ashkali nëshoqërinë kosovare

3. METODOLOGJIA

Duke u nisur nga fakti që në Kosovë janë zhvilluar një numër i madh i hulumtimeve dhe raporteve monitoruese dhe vlerësuese për fenomenin e braktisjes së shkollës, kjo analizë është karakterizuar më shumë me shqyrtim të dokumentacionit ekzistues, dhe analizë e raporteve dhe gjetjeve kryesore nga këto raporte dhe hulumtime, duke e plotësuar me të dhënat e gjetura edhe gjatë punës në terren.
I gjithë procesi i ka pasur tre faza kryesore. Gjatë **fazës së parë** janë shqyrtuar dhe analizuar të gjitha dokumentet relevantë për çështjen e braktisjes së shkollimit nga fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto dokumente përfshijnë mbi dhjetë raporte nga hulumtimet, monitorimet dhe vlerësimet e mëhershme, të gjitha ligjetdhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën e arsimit, përkatësisht fushën e gjithëpërfshirjes, politikat e strategjitë në nivel qendror dhe lokal, statistikat nga SMIA, etj.

Faza e dytë është karakterizuar me vizitat në terren ku janë zhvilluar intervista gjysmë të strukturuara individuale me nxënës, prindër, mësimdhënës, drejtorë të shkollave, punëtorë të organizatave joqeveritare dhe zyrtarë të arsimit. Duhet theksuar që ky proces është karakterizuar edhe me shumë takime individuale e grupore me qëllim që informatat e gjetura gjatë analizës së përmbajtjeve (faza e parë) të validohen apo edhe të plotësohen me informata shtesë.

Gjatë **fazës së tretë** janë zhvilluar vizita në shkolla me karakter vëzhgues dhe biseda të rastit me stafin shkollor dhe aktivistë të OShC-ve.
Gjithsesi duhet potencuar që kjo analizë dominohet nga të dhënat e nxjerra nga dokumentet ekzistuese, duke e pasuruar me të dhënat nga terreni dhe literatura ndërkombëtare.
Gjatë punës në terren i është kushtuar rëndësi e veçantë aspekteve etike. Marrë parasysh që hulumtimi ka një dozë të lartë të ndjeshmërisë pasi ka të bëjë me fëmijët dhe me çështje personale, jemi përkujdesur maksimalisht që të krijojmë një ambient miqësor gjatë bisedave, ku i është kushtuar kujdes ruajtjes së integritetittë fëmijëve dhe ruajtjes së fshehtësisë për informacionet e grumbulluara.

4. TË GJETURAT E ANALIZËS

Në Doracakun "Të gjithë në shkollë" [9] të hartuar në kuadër të nismës së përbashkët nga MAShT dhe CRS, janë renditur tre shkaqe kryesore që qojnë deri te braktisja e shkollës:

1. gjendja e vështirë ekonomike
2. mungesa e dëshirës nga ana e fëmijëve
3. punësimi i hershëm i fëmijëve dhe të rinjve

Këto shkaqe janë identifikuar nga hulumtimi "Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë" [10] të zhvilluar nga UNICEF dhe MAShT në vitin 2004. Të gjitha hulumtimet e zhvilluara ndër vite, situatën e rëndë ekonomike dhe sociale e renditin si arsyen kryesore që i kontribuon braktisjes së shkollimit. Kjo është shumë e shpërfaqur tek fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Gjetjet e Raportit të vlerësimit [11] të zbatimit për vitin 2017 të Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, së bashku me gjetjet e kësaj analize vejnë në rend të parë këto shkaqe:

1. kushtet e rënda ekonomike,
2. nivelii lartë i papunësisë,
3. niveli i ulët i edukimit dhe vetëdijes së prindërve mbi rëndësinë e shkollimit,
4. diskriminiminë shkolla,
5. qasja në infrastrukturë përkatëse deri në shkollë,
6. mungesa e mësuesve me origjinë rome, ashkali dhe egjiptian, dhe
7. migrimi i familjeve për arsye ekonomike dhe kthimi prapa në Kosovë.

Në hulumtimin "Përmirësimi i arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë - nxitja e arsimit gjithëpërfshirës dhe diversitetit në shkollat e Kosovës" [12] thuhet *"...shkalla e braktisjes së shkollës është shqetësuese, ndërsa çështjet ekonomike janë ndër shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës..."*.[13]

9. Tëgjithënëshkollë, Parandalimidhereagimindajbraktisjesdhemossergjistrimittënxënësvenëshkollë, MAShTdhe SHPA, Prishtinë, tetor 2005
10. "Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë", UNICEF, MAShT, Nëntor 2004
11. Raport Vlerësimi për vitin 2017- Zbatimi I Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare
12. Përmirësimi i arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë - nxitja e arsimit gjithëpërfshirës dhe diversitetit në shkollat e Kosovës, ECMI Kosovë, botuar në kuadër të "Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC)", Prishtinë, Korrik 2018
13. Po aty, f. 15

Raportet vlerësuese dhe hulumtuese për fenomenin e braktisjes të publikuara nga Instituti Pedagogjik i Kosovës,[14] po ashtu renditin kushtet e vështira ekonomike si njërin ndër arsyet kryesore të braktisje së shkollës.

Shkaqet apo arsyet që ndikojnë në braktisjen e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të përmendura më lartë, tregojnë situatën e përgjithshme për fenomenin e braktisjes së shkollës. Kjo analizë nxjerrë në pah edhe faktorë të tjerë të cilët ndikojnë në braktisjen e shkollimit. Në Doracakun "Të gjithë në shkollë" përmenden katër grupe të faktorëve që ndikojnë në fenomenin e mos-regjistrimit dhe braktisjes së shkollës. Këta faktorë janë të grupuar në: 1. Faktorët individual; 2. Faktorët familjarë; 3. Faktorët shkollorë dhe 4. Faktorët social. Po ashtu, faktorët e paraqitur më lartë janë pjesë e Doracakut[15] për Ekipet shkollore për parandalimdhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar, si mjet që i është ofruar të gjitha shkollave për të ndihmuar zbatimin e UA-19/2012 (tani UA-08/2018).

Ekziston një ndërlidhshmëri e madhe në mes të këtyre katër grupimeve të faktorëve, që është paraqitur në skemën më poshtë, ndërsa në vazhdim të analizës do ti shkoqisim të gjithë faktorët duke i krahasuar edhe me të dhënat nga intervistat dhe bisedat me komunitetin shkollor dhe hisedarët tjerë të përfshirë në proces.

14. http://ipkmasht.rks-gov.net/
15. http://www.ecmikosovo.org/uploads/Doracak%20per%20EPRBM%20Shkollore_SHQ.pdf



Faktorët që ndikojnë në fenomenin e mos-regjistrimit dhe braktisjes së shkollës

4.1. Faktorët individual

Gjithnjë sipas Doracakut për Ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit, faktorët individual që mund të shpijnë deri te braktisja janë: sëmundjet e ndryshme, aftësitë e kufizuara, martesat e hershme, përkrahja nga familja, përfshirja në dukuri negative, qasja individuale ndaj arsimit etj.

Fëmijët të cilët kanë ndonjë sëmundje kronike apo ndonjë aftësi të kufizuar, kanë predispozita të mëdha që të mos regjistrohen fare në shkollë, apo, nëse janë regjistruar, të e braktisin atë. Qasja ndaj këtyre fëmijëve duke filluar nga ambienti familjar e deri te ai shkollor është shumë e rëndësishme. Bashkëpunimi i mirëfilltë në mes të shkollës dhe familjes do të ndihmonte dhe ndikonte drejtpërdrejt në krijimin e një ambienti miqësor për fëmijët.

Martesat e hershme tek pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të mbeten faktorë kontribuues në braktisjen e shkollimit. Sipas të dhënave të MICS[16] - Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë e zhvilluar në vitet 2013-2014, përqindja e të rinjve të moshës 15-19 vjeçare që janë të martuar ose në bashkëjetesë është si në vijim: Femra 17.8% dhe Meshkuj 3.8%. Megjithatë, nga takimet dhe intervistat e zhvilluara në terren kemi kuptuar që ekziston një dallim signifikant i shpërfaqjes së kësaj dukurie në qytete dhe fshatra të ndryshme. Thënë ndryshe, për shkak të punës së madhe që është bërë në ngritjen e vetëdijes, sidomos nga organizatat jo-qeveritare, për fenomenin e martesave të hershme, në zonat urbane ka një trend të zvogëlimit të kësaj dukurie, përderisa në zona ku aktivitetet dhe puna e organizatave ka qenë më e limituar, kemi një situatë pak më komplekse, e që pasqyrohet edhe në të dhënat e MICS. Ky kompleksitet, buron nga mentaliteti kulturor dhe qëndrimet patriarkale refuzuese ndaj ndryshimeve, që janë derivat i stereotipizimit të punës që bëhet nga shumë OJQ.

Tek faktorët individual përfshihet edhe përkrahja nga familja dhe qasja individuale ndaj arsimit. Do të ishte utopike nëse ne mendojmë që fëmijët e moshës shkollore, sidomos ata të arsimit të obliguar, mund të krijojnë qëndrim të qartë kundrejt rëndësisë së arsimit. Fëmijët mund ta duan apo mos ta duan shkollën për shkak të ambientit shkollor, për shkak të interaksionit që kanë me bashkëmoshatarët, për shkak të (mos) punës dhe (mos) përkushtimit nga ana e stafit shkollor dhe familjes.

Fëmija si një qenie fragjile dhe në proces të formësimit të personalitetit, e ka të vështirë që të analizojë dhe rezonojë arsyeshëm për çështjet mbi të cilat mund të ndërtohet e ardhmja e tij/saj. Për këtë arsye, familja ka rolin kryesor tek menaxhimi i duhur i faktorëve individual.

16. http://ask.rks-gov.net/media/1883/komunitetet-rome-ashkali-dhe-egjiptiane-ne-kosove-2013-2014.pdf

4.2. Faktorët familjarë

Faktorët familjarë që mund të shpijnë deri te braktisja e shkollës janë: mungesa e kujdesit adekuat prindëror, niveli i arsimimit të prindërve, mentaliteti kulturor i familjeve, mos-bashkëpunimi / mos-adaptimi i familjes me rrethin, fëmijët si mbajtës të familjes etj.

Kur jemi tek faktorët familjarë duhet patjetër të përmendim Kornizën e Përfshirjes[17] të hartuar nga sociologia Joyce L. Epstein, nga Johns Hopkins[18] University. Ajo në modelin e përfshirjes së familjes për të nxitur suksesin në shkollë dhe partneritetin shkollë-familje, prezanton gjashtë forma të përfshirjes: Prindërimi, Komunikimi, Vullnetarizimi, Mësimi në shtëpi, Vendimmarrja dhe Bashkëpunimi me Komunitetin.

Nëse i analizojmë secilën nga këto gjashtë forma të përfshirjestë proklamuara nga Epstein, shohim se përfshirja e familjes në shkollë ka rol kyç dhe të pazëvendësueshëm. Kjo konfirmohet edhe nga intervistat që janë zhvilluar me mësimdhënës dhe drejtorë shkollash. Secili prej tyre e ka spikatur rëndësinë e përfshirjes së prindërve, përkatësisht familjes në shkollë. Por, për të ndodhur një gjë e tillë, bashkëpunimi duhet të jetë bilateral, përkatësisht, institucionet shkollore duhet të krijojnë në ambient të tillë miqësor edhe për prindërit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Shembull negativ kundrejt kësaj qasje na është ofruar gjatë bisedës më përfaqësues të OJQ-ve që zhvillojnë aktivitetin në një shkollë në Prizren, ku drejtori i shkollës në mënyrë demonstrative ka larguar nga hapësira shkollore prindërit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët kishin ardhur për t'u takuar me Mediatorët që lehtësojnë komunikimin e shkollës me familjet.

17. https://www.sps186.org/downloads/table/13040/6TypesJ.Epstien.pdf
18. https://education.jhu.edu/directory/joyce-l-epstein-phd/

4.3. Faktorët shkollorë

Një grupim tjetër i faktorëve që mund të shpijnë deri te braktisja e shkollës janë: pozita gjeografike e shkollave, marrëdhëniet arsimtar-nxënës dhe nxënës-nxënës, mungesa e shërbimeve profesionale në trajtimin e problemeve brenda shkollës, bashkëpunimi i mangët shkollave me komunën dhe komunitetin, ndikimet e dukurive të jashtme negative etj.

Në bazë të të dhënave nga intervistat dhe takimet e realizuara konstatohet se problemi i pozitës gjeografike të shkollave mund të ndikojë më shumë në braktisjen e shkollimit gjatë tranzicionit në nivelet e arsimit, përkatësisht kalimi nga shkolla e mesme e ulët në atë të mesme të lartë. Megjithatë, nëse bëjmë një korrelacion në mes të faktorëve të ndryshëm, mund të konstatojmë se shumë faktorë e ushqejnë njëri-tjetrin. P.sh. përkushtimi më i madh i familjes për të përkrahur fëmijën në vazhdimin e shkollimit, edhe përkundër pozitës gjeografike të shkollës, pra, edhe përkundër largësisë në relacionin shtëpi-shkollë, ka dhënë efektin e vetë. Po ashtu, përkrahja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian përmes skemës së bursave nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë në bashkëpunim me partnerët zhvillimor dhe organizatat jo-qeveritare (KFOS, KEC, HEKS, VoRAE, REF), ka ndikuar shumë në përfshirjen e nxënësve në sistemin arsimor të niveli 3 të ISCED. Faktorë tjetër i rëndësishëm është ambienti që krijohet në shkollat tona, e që ka të bëj me marrëdhëniet dhe nivelin e bashkëpunimit në mes të mësimdhënësve me nxënësit, në këtë rast me ata nga radhët e komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu, ambienti miqësor ka ndërlidhje edhe me trajtimin që i bëhet nxënësve nga stafi i shkollës, por edhe nga vetë bashkëmoshatarët. Një e dhënë nga Raporti i vlerësimit[19] të zbatimit për vitin 2017 të Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, identifikon diskriminimin në shkolla si një nga shkaktarët që ndikon në braktisjen e shkollës nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

"Të gjithë duhet të kenë një mundësi për të mësuar në një mjedis pozitiv, të shijojnë procesin e të mësuarit dhe të ndjehen të qetë dhe të kënaqur brenda tij".[20] Kjo thënie nga z. BarrySaide, Drejtor shkolle në "RooseveltSchool", autor i njohur i shumë shkrimeve dhe publikimeve nga fusha e arsimit, tregon shumë qartë për rëndësinë e mjedisit pozitiv, të sigurt dhe atraktiv për të gjithë fëmijët, për t'iu mundësuar atyre arritje sa më të larta dhe shfrytëzim të potencialit. Në këtë kontekst duhet thënë që stafi shkollor duhet të përkujdeset maksimalisht që shkollat tona të shndërrohen në ambiente të tilla, miqësore, pozitive dhe të hapura për të respektuar diversitetin si vlerë njerëzore.

19. RaportVlerësimipërvitin 2017- ZbatimiiStrategjisëpërpërfshirjen e komuniteteveromdhe ashkali nëshoqërinëkosovare
20. BarrySaide, Drejtor shkolle në "RooseveltSchool" (https://www.barrysaide.com/)

Nga intervistat e zhvilluara dhe nga vëzhgimet që janë bërë është vërejtur se ekzistojnë raste të trajtimit diskriminues të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian nga bashkëmoshatarët, madje, ka pasur edhe raste të trajtimit diskriminues edhe nga vetë mësimdhënësit. Kjo ndodh për shkak se shumë mësimdhënës nuk janë të pajisur mjaftueshëm me kompetenca për të menaxhuar situatat në klasë mbi parimin e barazisë shoqërore, prandaj përdorin metoda të gabuara disiplinimi.
Po ashtu, janë vërejtur raste të komunikimit jo konstruktiv me fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, mos-integrim të këtyre fëmijëve në aktivitete jashtëshkollore dhe jashtë-mësimore, vendosje të tyre në rreshtat e fundit të klasave, e ndonjëherë stigmatizim të tyre përmes llojeve të ndryshme të shtypjeve psikologjike.

21.http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/11/A2.1.5.2.-Need-Assessment-ALB-Final-Report.pdf

4.4. Faktorët social

Gjithnjë sipas Doracakut për Ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit, faktorët individual që mund të shpijnë deri te braktisja e shkollës janë: problemet sociale/ varfëria, niveli i mangët i bashkëpunimit ndër-institucional dhe me komunitetin, dukuritë negative brenda shoqërisë, migrimet, etj. Faktorët social ndryshe mund të definohen si faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë në braktisjen e shkollimit. Në të gjitha hulumtimet dhe vlerësimet e bëra deri më tani për problemin e braktisjes, një ndër shkaqet kryesore të paraqitjes së braktisjes së shkollës nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është gjendja sociale dhe ekonomike e familjeve. Mobilizimi shoqëror dhe një bashkëpunim u shtuar në mes të institucioneve të ndryshme në nivel lokal meOShC-të ka dëshmuar se edhe përkundër që shumë familje nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përballen me probleme të mëdha ekonomike dhe varfëri, fëmijët kanë vazhduar shkollimin dhe vijueshmëria e tyre ka qenë e rregullt. Ofrimi i librave falas nga MAShT dhe përkrahja me pako shkollore nga projekte të ndryshme, ka ndikuar po ashtu në vijueshmërinë e rregullt të shkollës nga fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Në bazë të të dhënave të grumbulluara gjatë takimeve me mësimdhënësit, është kuptuar që pajisja e nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian me mjete shkollore ka ndikuar pozitivisht në vijueshmëri. Madje, shumë nga mësimdhënësit kanë thënë se çdo masë e tillë afirmative ka pasur edhe efekt motivues për nxënësit. Një shembull pozitiv në këtë aspekt mund të përmenden projektet që kanë përkrahur Qendrat Mësimore. Në raportin "Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunat Gjakovë, Pejë dhe Istog",[21] i zhvilluar gjatë vitit 2016 tregon se në lokacionet ku ekzistojnë Qendrat Mësimore, vërehet një përfshirje shumë më e lartë e nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në të gjitha nivelet e arsimit. Po ashtu edhe studimi "Ndikimi i Qendrave Mësimore në përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim" konfirmon se "*Qendra Mësimore kontribuojnë në përmirësimin e performancës së nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë.*
Puna e Qendrave ka rezultuar në vijim më të rregullt, nota më të mira, shkallë më të ulët të braktisjes dhe rritje të përfshirjes sociale të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian"[22]

22. Ndikimi i Qendrave Mësimore në përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim, KOSINT 2020, Prishtinë, Nëntor 2018
23. Raport Vlerësimi për vitin 2017- Zbatimi i Strategji për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare
24. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15304

Gjetjet e Raportit të vlerësimit[23] të zbatimit për vitin 2017 të Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, tregojnë se migrimi i familjeve për arsye ekonomike dhe kthimi prapa në Kosovë, po ashtu ka ndikuar në braktisjen e shkollimit. Për familjet e ri-atdhesuara, problemi i braktisjes është mjaft i shfaqur dhe ndikimi mbetet shumëdimensional në raport me braktisjen e shkollimit. Problemi i parë është që familjet e ri-atdhesuara përballen me probleme shumë të mëdha, duke filluar nga strehimi, ushqimi, problemet ekonomike, dhe dërgimin e fëmijëve në shkollë e shohin si çështje të parëndësishme apo të dorës së dytë.

Problemi i dytë lidhet me vazhdimin apo mos-vazhdimin e shkollimit nga fëmijët gjatë kohës që kanë qenë jashtë Kosovës. Njohja apo mos-njohja (nostrifikimi) e dokumenteve, vështirësitë për të siguruar këto dokumente nga vendet ku kanë qenë, mbetet sfidë e madhe për fëmijët e rikthyer. Problemi i tretë është mos-njohja e gjuhës shqipe nga disa fëmijë të ri-atdhesuar. Pra, ashtu siç definohen edhe në Rregullore (QRK) nr. 13/2017 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, [24] organet dhe mekanizmat përgjegjës duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet për të siguruar përfshirje në shkollë të fëmijëve nga familjet e ri-atdhesuara në Kosovë.

5. REKOMANDIMET

Duke u bazuar në të gjeturat të kësaj analize të gërshetuara me të gjeturat edhe të shumë hulumtime dhe vlerësimeve të zhvilluara deri më tani, për të adresuar në mënyrë sa më të mirë problematikën e braktisjes së shkollimit, ofrohen këto rekomandime kryesore:

1. Të gjitha institucionet përgjegjëse duhet të angazhohen më shumë në përmirësimin e kushteve ekonomike dhe zvogëlimit të papunësisë dhe varfërisë tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, për të krijuar kushte të domosdoshme brenda familjeve për të përkrahur shkollimin e fëmijëve;
2. Edhe përkundër punës së deritashme në ngritjen e vetëdijes së prindërve mbi rëndësinë e shkollimit, duhet të ndërmerren fushata gjithëpërfshirëse informuese dhe vetëdijësuese për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në mënyrë që ata ta kuptojnë rolin shumë të rëndësishëm që ka arsimi i fëmijëve, në funksion të përmirësimit të kualitetit të jetës në të ardhmen. Prezantimi i "storieve të suksesit" nga pjesëtarët e komuniteteve mund të kenë rol të rëndësishëm në këto fushata.
3. Trajnimet që janë zhvilluar për mësimdhënës në aspektin e gjithëpërfshirjës, anti-diskriminimit dhe diversitetit, kanë pasur impakt vetëm në ato shkolla ku është mbikëqyrë zbatimi i këtyre teknikave dhe metodologjive në klasa. Ekziston një diskrepancë e madhe në mes të nivelit deklarativ të respektit për diversitetin në krahasim me realitetin në klasat tona. Organizimi i trajnimeve të tilla, të përcjellura me zbatim të drejtpërdrejt në klasa dhe monitorim rigoroz nga institucionet dhe përgjegjësit është i domosdoshëm.
4. Vazhdimi i përkrahjes me bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta është i domosdoshëm. Kjo përkrahje duhet të përcillet me mentorim të vazhdueshëm të nxënësve përfitues, dhe monitorim të përmbushjes së obligimeve nga përfituesit.
5. Institucionet dhe OJQ-të që ofrojnë çfarëdo përkrahje (bursa, pako shkollore, shujta, materiale didaktike etj.) për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duhet të bëjnë kujdes për mënyrën e shpërndarjes dhe obligimeve që duhet të përmbushin përfituesit, kundrejt përfitimit. Është jetike që përkrahja që

ofrohet të mos krijojë varësi, ngase të dhënat nga analiza na dëshmojnë se varësia nga përkrahja, në një moment të caktuar mund të bëhet shkak kryesor i braktisjes së shkollimit.

6. Përditë e më shumë ka përfaqësues nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që kanë përfunduar shkollimit universitar përkatës, dhe janë të gatshëm për t'u punësuar në institucione edukative-arsimore. Komunat duhet të respektojnë kuotën e punësimit duke u mundësuar punësim të mësimdhënësve nga këto komunitete.
7. Përtej zhvillimeve pozitive në aspektin e hartimit të politikave që rregullojnë këtë problematikë, ekziston nevoja që përgjegjësit të zbatojnë me përpikëri obligimet që dalin nga Rregulloret, Udhëzimet Administrative, Strategjitë e Planet e Veprimit. Institucionet përgjegjëse mbikëqyrëse duhet të jenë më aktive në mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe obligimeve ligjore. Mos-ndëshkimi për mos-zbatim, krijon shembull negativ dhe ka efekt zinxhiror edhe tek institucionet tjera.
8. Secila shkollë dhe komunë që ka krijuar dhe funksionalizuar Ekipet për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mos-regjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, kanë arritur rezultate shumë pozitive në parandalim dhe trajtim të fenomenit të braktisjes së shkollimit. Funksionalizimi i Ekipeve në të gjitha shkollat do të krijonte një situatë të re në arsimin e Kosovës në raport me fenomenin e braktisjes.

6. PËRFUNDIMET

Të gjeturat e kësaj analize të gërshetuara me të gjeturat edhe të shumë hulumtime dhe vlerësimeve të zhvilluara deri më tani, kanë identifikuar arsyet që ndikojnë në braktisjen e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, që janë grumbulluar në katër grupime të faktorëve: 1. Faktorët individual; 2. Faktorët familjarë; 3. Faktorët shkollorë dhe 4. Faktorët social. Të gjithë faktorët e identifikuar janë shtjelluar dhe arsyetuar në kuadër të kësaj analize. Në bazë të të gjeturave, konstatojmë se fenomeni i braktisjes është shumë kompleks dhe implikon qasje gjithëpërfshirëse, graduale dhe të vendosur, në mënyrë që trajtimi i problemit të braktisjes të normëzohet si vlerë brenda secilit institucion arsimor, dhe assesi të mos mbetet në nivel të përmbushjes së aspektit formal dhe deklarativ.

Krejt në fund, grupimi i faktorëve ka për qëllim lehtësimin e punës së përgjegjësve për të adresuar problematikën e braktisjes. Mirëpo, asnjë intervenim nuk duhet të standardizohet dhe shfrytëzohet si tërësi e veprimeve që duhet replikuar në secilin rast. Pra, secili rast i braktisjes është unik dhe kërkon veprime unike, andaj është i domosdoshëm shfrytëzimi i procedurave që burojnë nga Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm, për të identifikuar secilin rast që në fillimet e tij dhe ndërmarrë veprimet konkrete, varësisht nga specifikat e rastit.

2020 KOSINT

Kosovo Integration Initiative
Iniciativa e Kosovës për Përfshirje

ROMA INTEGRATION 2020
Regional Cooperation Council